



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr 11 22 prot

Vau Dejës, me 17 . 02 2023

Lënda: Dërgohet materiali për shqyrtim dhe miratim.

Z.Mark Bisha
KRYETAR I KESHILLIT BASHKIAK VAU DEJËS

I nderuar z.Kryetar,

Bashkëlidhur po ju dërgojmë Projekt Vendimin për “Dhënien e shtesës mbi pagë për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin e punonjësve për vitin buxhetor 2023”.

Bashkëlidhur:

- Projekt Vendimi

Faleminderit për bashkëpunimin.

KRYETARI
Mark Babani





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

PROJEKT VENDIM

Nr 01 Dt 17.02 2023

**PËR
DHËNIEN E SHITESËS MBI PAGË PËR PUNË TË VËSHTIRA E TË DËMSHME PËR
SHËNDETIN E PUNONJËSVE PËR VITIN BUXHETOR 2023**

Bazuar në nenin 53 pika 2, neni 54 pika ç, e Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në Ligjin Nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në ligjin Nr.152/2013, në Ligjin Nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr.84/2022, “Për buxhetin e shtetit të vitit 2023”, në ligjin Nr.152/2013, “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar, në VKM Nr.625, datë 28.09.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr.165 datë 02.03.2016, “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionareve të zgjedhur e të emeruar, të nëpunësve civile dhe të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar, pika 4, në VKM Nr.604, datë 14.09.2022, “Për caktimin e pagesës miniale në shkallë vendi” në pikën 3/a, lidhja III, e VKM Nr.234, datë 20.04.2022, “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar, në Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës. Nr 567, datë 05.12.2022, “Për miratimin e strukturës organizative, organigramën, kategoritë dhe klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe administrativ për vitin buxhetor 2023” me propozimin e Sektorit të Burimeve Njerëzore, Kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak të:

VENDOSI:

- I Z. Denis Shkoza i punësuar në pozicionin: “Përgjegjës i Sektorit të Informimit Publik, Medias dhe IT”, niveli i diplomës “Bachelor”, në degën “Inxhinieri Kompjuterike”, t’i jepet një shtesë mbi pagë në masën 5000(pesë mijë) lekë në muaj, bazuar në pikën 9, të VKM Nr.165 datë 02.03.2016.

- II Z. Sabion Beqiri i punësuar në pozicionin: “Specialist në Sektorin e Informimit Publik, Medias dhe IT”, niveli i diplomës “Bachelor”, në degën “Informatikë”, t’i jepet një shtesë mbi pagë në masën 5000(pesë mijë) lekë në muaj, bazuar në pikën 9, të VKM Nr.165 datë 02.03.2016.
- II/ Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

KRYETARI
Mark Babani

